



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS / OPŠTINA KOŠOVO-POLJE
MUNICIPALITY OF FUSHË-KOSOVË/KOSOVO-POLJE



Datë: 20.07.2020

Në bazë të nenit 13, të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040, (Gazeta Zyrtare Nr. 28/2008), nenit 8, të Rregullores së Ministrisë së Financave dhe Transfereve, MF-Nr.04/2017, të datës 13.06.2017, mbi kriteret standardet dhe procedurat e financimit publik të Organizatave Jo Qeveritare, nenin 44, të Statutit të Komunës, Nr. 98, i datës 17.08.2012, bënë këtë :

THIRRJE PUBLIKE PËR APLIKIM

Njoftohen përfaqësuesit e organizatave të shoqërisë civile se mund ti dërgojnë propozimet e tyre për plotësimin e Komisionit vlerësues i cili do të formohet me qëllim të vlerësimit të aplikacioneve për financimin e projekteve/programeve, të OJQ-ve që veprojnë në Komunën e Fushë Kosovës për projektet që kontribuojnë në:

- Promovimi dhe përkrahëja e aktiviteteve të cilat kanë të bëjnë me përmirësimin e gjendjes sociale të familjeve me gjendje të rëndë ekonomiko-sociale .
- Lehtësimin e gjendjes së kategorive të personave me nevoja të veqanta :
- Ofrimi i shërbimeve dhe mbrojtja e kategorive të personave në nevoj të cilët janë të organizuar në shoqata të ndryshme, avancimin dhe afirmimin e Drejtorisë për Shëndetësi dhe Mirqenie Sociale të cilët kanë aplikuar sipas thirrjes publike për aplikim të dates : 13.07.2020.

Ky Komision do të formohet me qëllim të vlerësimit të aplikacioneve për financimin e projekt/programeve të OJQ-ve për avancimin dhe afirmimin e Shëndetësi dhe Mirqenies Sociale në Komunën e Fushë Kosovës, ku do të plotësohet me:

- Një përfaqësues nga Organizatat Jo Qeveritare
- Një përfaqësues nga shoqëria civile në cilësinë e ekspertit

Propozimet tuaja do të jenë të mirëpritura dhe duhet ti drejtohen Drejtorisë për Shëndetësi dhe Mirqenie Sociale dhe të njejtat të dorëzohen në ndërtesën e Komunës së Fushë Kosovës (zyra pritëse) për shërbim me qytetarë më së largu deri më datë: 03.08.2020.

Nr: 02/2020
Fushë Kosovë

